

ERVIN KAÇIU

TRAJEKTORE TË SKAJIMIT TË ROMËVE GJATË PERIUdhËS SË QEVERISJES SË MBRETIT ZOG DHE REGJIMIT NAZI-FASHIST¹

Abstrakt

Në këtë artikull diskutohet mbi pozitën sociale të romëve brenda dy regjimeve të modernitetit shqiptar, qeverisjes së mbretit Zog dhe regjimit nazi-fashist. Mbështetur në dokumente arkivore dhe në qëmtimin e teksteve të etnografëve, udhëtarëve e historianëve vendas e të huaj, në këtë artikull diskutohet mbi politikatat e zbatuara kundrejt romëve nga regjimet e ndryshme ideologjike që gjallojnë në këtë periudhë të modernitetit shqiptar, të cilat pikëtakohen në kushtin e modernizimit të kësaj pakice, ashtu si edhe të gjithë shoqërisë. Politikatat shtetërore të këtyre regjimeve megjithëse dallojnë në qasje dhe mekanizmat e përdorur në zbatimin e tyre në praktikë, rezultati që prodhojnë në finalitet është përjashtimi sistematik i romëve.

Fjalë kyçe: Përjashtimi, skajimi, moderniteti, modernizimi

Abstract

This article discusses the social position of Roma people within two regimes of Albanian modernity, the government of King Zog and the Nazi-fascist order. Based on archival documents and the literature produced by ethnographers, travelers, local and foreign historians, the main point of this article is to analyze the policies implemented toward Roma by

¹ Çështjet e diskutuara në këtë artikull janë sythe të një monografie në proces botimi, në të cilën, përmes një qasjeje diakronike, përpiqem të lexoj raportin e romëve me shtetin dhe shoqërinë në modernitetin shqiptar, nisur prej periudhës së pavarësisë e deri në bashkëkohësi.

various ideological regimes that in this period of Albanian modernity aimed at the modernization of this minority as well as of that of the whole society. The state policies of these regimes are different in approach and mechanisms used in the implementation. However, the final result they produce is the systematic exclusion of Roma minority.

Keywords: Exclusion, marginalization, modernity, modernization

I. Hyrje

Ky artikull shënjohe si një punë kërkimore që i bashkohet shtegut të hulumtimeve antropologjike mbi modernitetin në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit. Analiza e efekteve të modernitetit shqiptar mbi romët propozohet njëherazi si një thjerrë leximore e dy regjimeve të modernitetit shqiptar mes periudhës së qeverisjes së mbretit Zog dhe regjimit fashist e nazist, ashtu edhe si një ekzaminim i pozitës shoqërore të romëve brenda këtyre proceseve modernizuese. Artikulli bazohet në shqyrtimin e dokumenteve arkivore dhe teksteve të studiuesve shqiptarë e të huaj, të cilët kanë përfshirë drejtpërdrejt apo tërthorazi Romët në studimet e tyre.

Romët në Perandorinë Osmane ishin vetëm një prej fragmenteve të një mozaiku polietnik dhe multifetar në periferinë e saj, nën qeverisjen e një regjimi teokratik dhe ushtarak. Kjo, pavarësisht kontrollit të ushtruar nga ky regjim, mund të shihet si frymëmarrje për ekzistencën e një pakice që mund të ndërvepronte me të tjerët brenda një mjedisi plural, megjithëse bënin pjesë në “grupin e të padëshiruarve”. “Në esencë, për pakicat, Perandoria Osmane ishte mishërimi i një bashkëjetese etnike relativisht harmonioze dhe të fortë” (Barany 2002, 84). Ndërsa, prej shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë nga Perandoria Osmane në 1912-n, duhet të gjenin vendin e tyre brenda formacionit të ri politik të shtetit-komb. Me shfaqjen e ideologjive të modernitetit, duke nisur prej shtetit-komb e deri te fashizmi e socializmi, subjekti vihet përballë kushtit të rikonceptimit qenësor të vetes. Gjithçka i nënshtrohet operacioneve të inxhinierisë sociale të shtetit në funksion të përmbushjes së projekteve ideologjike. Në këto operacione

totale ndër komunitetet më vulnerabël ishin grupet pakicë të një etnie tjetër dhe akoma më në vështirësi ato të një race tjetër.

Qëmtimi i politikave të aplikuara kundrejt romëve në të dy regjimet e modernitetit përbën boshthin e analizës në këtë artikull, si një vektor kërkimi që mundëson shquarjen e taksonomive dominuese. Kriteret që janë aplikuar në klasifikimin e romëve, si një kategori sociale specifike përmes filtrimit ideologjik, kanë përcaktuar edhe qasjen e këtyre regjimeve në “administrimin” e këtij grupi etnik. Emëruesi i përbashkët i të gjitha regjimeve të modernitetit është kategorizimi i romëve si një *problem* që duhet zgjidhur. Faktet dhe të dhënat që diskutohen në këtë artikull të shpjen në përfundimin që skajimi i romëve, përveçse një fakt social në të tashmen, është një dukuri që e ka shoqëruar këtë pakicë përgjatë gjithë rrugëtimit historik.

II. Romët nën qeverisjen e Zogut

Periudha kohore nga shpallja e pavarësisë deri në vendosjen e sistemit komunist është një periudhë e rikonceptimit tërësor të kufijve të jashtëm e të brendshëm të shoqërisë shqiptare. Sikurse edhe e dimë, njohja e Shqipërisë së pavarur la jashtë gjysmën e shqiptarëve, duke lënë kësaj jashtë kësaj vije kufitare, me gjasa, edhe shumë prej romëve shqiptarë. Për rreth 20 vite, deri në pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste dhe rikthimin e “Shqipërisë së Madhe”, shqiptarët u përballën me interesat ekspansioniste dhe urrejtjen e serbëve të etur për të “larë hesapet” në veri dhe grekëve në jug të Shqipërisë. Referuar këndvështrimit të serbëve ndaj shqiptarëve, Kolsti pohon që ndoshta askund tjetër romët nuk kanë qenë kaq afër me një etni tjetër në përbuzje se sa me shqiptarët (Crowe dhe Kolsti 1991, 52). Në mbrojtje të argumentit ai sjell si referencë rastin e një studenti serb në Universitetin e Beogradit, i cili mendonte se prejardhja e fjalës shqiptar është bashkimi i fjalës cigan dhe siptar, duke aluduar që janë i njëjti grup (po aty, 52 - 59). Një shembull po aq domethënës është libri i Vladan Gjorgjeviç, *Shqiptarët e Fuqitë e Mëdha* ku, në vazhden e propagandës dehumanizuese të shqiptarëve, për ngjashmëri me prapambetjen përdoret krahasimi me romët. Me pretendimin që mbështetej në të dhëna

etnografike,² për Gjorgjeviç shqiptarët ishin “thatanik, të shkurtër, me tipare fenikase dhe tipare të romëve, që madje flisnin dhe gjuhën rome - gjë që i kujtonte paraardhësit e njeriut që flinin në pemë të kacavjerrë me bishtin e tyre” (Gjorgjeviç 2015).

Në këtë periudhë, Shqipëria u përball me kriza të brendshme politike të herëpashershme dhe me pasiguri serioze në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Shteti shqiptar dhe madje territoret e saj ishin vazhdimisht të rrezikuara. Siç edhe e dimë, po flasim për një nga epokat më të vështira të njerëzimit, dy luftëra të përmasave eskatologjike, që morën shumë jetë njerëzish dhe lanë pas mizerje e shkatërrim. Në këtë vorbull zhvillimesh të mbrapshta, Shqipëria ishte një nga vendet më vulnerabël, më të varfra dhe më të prapambetura. Pavarësia sollti shumë zhvillime pozitive, por, megjithatë, deri në prag të Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri më shumë se 80% e popullatës ishte analfabete, 85% jetonte në fshat por vetëm 9% e tokës ishte e punuar, shumica e fshatrave nuk kishte energji elektrike, nuk kishte asnjë hekurudhë dhe vetëm 2000 km rrugë të shtruara (Kastelan 1991, 453-454). Në këtë kontekst është e vetëkuptueshme që romët e Shqipërisë po ashtu jetonin në kushte shumë të vështira. Romët vazhdonin që të tregtonin mallra në tregjet lokale dhe komunitetet nomade të ndërtonin vendbanimet e tyre provizore në rrethinat e fshatrave dhe qyteteve. Në vëzhgimin e historianit Swire të një lagjeje romësh sedentarë, në vitin 1930, pasqyrohet ky përkrahim:

“Një grumbull shtëpishë të bardha dhe të pastra në të cilat jetojnë ciganë që duke mos qenë prej kohësh nomad kanë humbur gjuhën e tyre... Lloji i tyre është shumë i butë dhe mjaft ndryshe nga shqiptari mesatar, por i ngjashëm me Vllehët fiziku i tyre është i dobët.

Burrat, kur i duhet të punojnë, bëhen hamallë, farkëtarë ose xhelatë ose pastrues - është Cigani që mbytyt qenin endacak dhe mban karrocet e plehrave, punë të cilat shqiptari nuk do të përulet ti bëjë. Ka shumë prej tyre në porte, ku ata punojnë si hamall në anije, varkëtar dhe portier. Gratë janë trupmadhe, punëtore, shumë më të mira sesa myslimanët e Tiranës dhe ato shpesh janë të punësuar si shërbëtore, për shkak se nuk i pëlqejnë shqiptarëve. Hundët e tyre janë dukshëm semitike. Inteligjenca e tyre është

² Për më shumë, shih analizën e studiuesit Nebi Bardhoshi mbi këtë çështje (2021, 249)

mesatare, por ata i mbajnë shtëpitë e tyre shumë më të pastra se shqiptarët e ultësirës. Sidoqoftë, këto të fundit i përçmojnë ata, klasa e vjetër zyrtare kanë shumë frikë se të huajt mund t'i mendojnë ata si shqiptarë. Madje në një rast ministri i brendshëm e ndaloi fotografimin e lagjes së ciganëve me frikën se mund të prezantohej si një imazh përfaqësues i Tiranës". Gjithashtu edhe romët nomadë janë dukshëm të pranishëm në Shqipëri. Ata besojnë në zotin suprem dhe në zota të ndryshëm natyrorë të simbolizuara nga dielli, hëna, agu dhe deti. Ata jetojnë në çadra afër qyteteve gjatë dimrit. Gratë praktikojnë parashikimin e fatit ndërsa burrat bëjnë shporta, litar dhe tregti kuajsh si të ngjashmit e tyre në vende të tjera". (Swire 1937, 196)

Pavarësisht se shqiptarët asokohe nuk jetonin në mirëqenie dhe vendi në përgjithësi përballej me probleme të shumëllojshme, përshkrimi shquan skajimin socio-ekonomik të romëve.

Në terma të përgjithshëm, në administrimin politik të Shqipërisë së pavarur nuk mund të flitet për hartimin e zbatimin e politikave të mirëfillta kundrejt romëve, deri në qeverisjen e Mbretit Zog në vitin 1928. Në regjimin autokratik të mbretit Zog, subjekte të platformës modernizuese u bënë edhe romët, ashtu si edhe segmente të tjera të shoqërisë. Kryesisht, politikat e ndërmarra ndaj tyre ishin të një natyre korrektuese e disiplinuese dhe jo në trajtat e operacioneve totale të një karakteri emancipues e asimilues. Në qoftë se do të bënim një lloj "hermeneutike" të politikave të ndërmarra mund lexohet tendenca kah emancipimit, por kemi të bëjmë vetëm me akte të sfazuara dhe jo sistematike. Në terma hipotetikë, mendoj se kjo mund të shpjegohet, nga njëra anë, me kohën e shkurtër të mbretërisë për të përmbushur shumësinë e objektivave të agjendës modernizuese. Ndërsa, nga ana tjetër, mendoj se romët nuk përbënin një entitet të rëndësishëm të vetë agjendës, ose, e thënë ndryshe, nuk u konsideruan seriozisht.³ Më saktë, u konsideruan vetëm si objekt i një politike estetike përmes administrimit të shfaqjes në hapësirën publike se sa si subjekt i politikave të një karakteri zhvillimor, me synim përmirësimin e gjendjes. Për shembull, Zogu, që prej vitit 1920, kohë kur mbante akoma

³ Referuar J. H. Tomes (2003, 147) pakicat, në përgjithësi, në këtë periudhë nuk ankoheshin për persekutim, por se ishin të pakonsideruara apo të harruara.

funksionin e ministrit të brendshëm nxori një urdhër që ndalonte kërcimin e romëve në publik (Kolsti 1991, 52).

Referuar dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit, qëndrimi i qeverisë në këtë periudhë mund të lexohet qartësisht si prirje diskriminuese në trajtat e *fshehjes* së kësaj pakice, duke mos i lejuar që të grumbullohen në qytete apo në rrethinat e tyre. Në 10 dokumente të gjetura në arkiv, në lidhje me vendimet e qeverisë lokale dhe qendrore mbi romët, shfaqen tri tipologji direktivash: *dëbimin e romëve nga qytetet; moslejimin e grumbullimit në qytete; ndalimin e hyrjes së emigrantëve romë në territorin e Shqipërisë*. Një fakt domethënës, që vlen të përmendet për të kuptuar këndvështrimin e shtetit ndaj romëve, është që nuk bëhej asnjë përpjekje për të stabilizuar një emërtim zyrtar mbi këtë pakicë. Në të gjithë dokumentet zyrtare romët identifikohen në zhargon si, arixhi, harixhi, jevgj dhe evgjit. Pa marrë përsipër të ndalem në analizë semantike të gjuhës formale, është me rëndësi të thuhet që, pavarësisht se asokohe kudo në Europë nuk ishte zyrtarizuar përdorimi i termit rom, mungesa e standardizimit të një emërtimi zyrtar, goftë edhe duke huazuar një nga emërtimet ekzistuese nga zhargoni popullor, tregon, më e pakta, përçmimin e autoriteteve shtetërore ndaj kësaj pakice.

Në një qarkore të Prefekturës së Tiranës, të datës 22.07.1930 drejtuar Qark-Komandës së Policisë së Bashkisë së Tiranës, kërkohet që:

“Me gjithë që ju keni komunikue urdhënin e Ministries dhe shkresë të posaçme nga ana e kësaj prefekturë mbi grumbullimin e Arixhinjve afër qytetit dhe pranë rrugave ku komunikacioni botnuer asht i shpeshtë, si dhe nga ky shkak kta vijnë e sillen ndëpër rrugët e qytetit tue lypë, prandaj ju kujtojmë edhe një herë dhe presim prej asaj komande përfundim të veprimit urdhënueshme, tue ndalue krejtë pa pasun nevojë përsëritje qi arixhijtë në fjalë të grumbullohen në rrugat publike dhe të vinë këtu.”⁴

Përpos kësaj qarkoreje, të gjitha vendimet e urdhrat e lëshuar asokohe, manifestojnë të njëjtën qasje të shtetit ndaj romëve.

- Qarkore e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe korrespondencë ndërmjet bashkisë, Prefekturës së Durrësit dhe komandës së

⁴ AQSh i RSH, Fondi 380, Dosja I-32, Viti: 1930, fl: 1.

xhandarmërisë, mbi ndalimin e Jevgjëve dhe Harixhinjëve të qëndrojnë nëpër rrugët kryesore të qytetit.⁵

- Urdhër i nënprefekturës Fier mbi marrjen e masave për largimin e Arixhinjve nga qyteti për të evituar përshtypjet mbi mënyrën e jetesës në vendin tonë.⁶
- Korrespondencë e Bashkisë së Tiranës me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prefekturën e Tiranës, mbi gjendjen e imigrantëve të ardhur nga Jugosllavia e Greqia, ndihmën urgjente që duhet t'u jepet në banesë, mjekime etj. si dhe ndalimin e futjes në Shqipëri nga Greqia të disa Arixhinjve.⁷
- Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Ministrinë e Punëve të Brendshme, mbi ndalimin e hyrjes së Jevgjëve dhe Arixhinjve në Shqipëri.⁸
- Korrespondencë e Përlimitares së Shkodrës me Prefekturën e Shkodrës, mbi dëbimin nga qyteti të Arixhinjve.⁹
- Lista, qarkore dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe prefekturave, mbi prejardhjen e Arixhinjve që ndodhen nëpër prefektura dhe largimin e lypësve nga Tirana.¹⁰
- Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Prefekturën e Korçës mbi largimin e Arixhinjve.¹¹
- Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe kjo e fundit prefekturave, mbi marrjen e masave që të mos lejojnë hyrjen në Shqipëri të harixhinjve Shqiptarë, që vijnë nga Mica pasi atje ka rënë sëmundja e kolerës.¹²

⁵ AQSh i RSH, Fondi: 236, Dosja: 36, Viti:1938, fl. 2.

⁶ AQSh i RSH, Fondi 223/1, Dosja 37, Viti: 1933, fl. 2.

⁷ AQSh i RSH, Fondi 380, Dosja: 56, 1936, fl. 13.

⁸ AQSH i RSH, Fondi 380, Dosja: 82, Viti: 1930, fl.: 4.

⁹ AQSh i RSH, Fondi 347, Dosja: 108, Viti: 1921, fl. 1.

¹⁰ AQSh i RSH, Fondi 152, Dosja: 271, Viti: 1929, fl. 22.

¹¹ AQSh i RSH, Fondi 152, Dosja: 283, Viti:1928, fl. 5.

¹² AQSh i RSH, Fondi 152, Dosja: 593, Viti: 1930, fl. 1

- Qarkore e Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar prefekturave, mbi mosgrumbullimin e popullit, sidomos të vobektët dhe jevgjit në dogana, në kohën kur zbresin turistët për arsye se lënë përshtypje të keqe.¹³

Dokumentet dëshmojnë se në cilat rrethana romët bëheshin të dukshëm për autoritetin apo, thënë ndryshe, kur bëheshin subjekt i qeverisjes. Është e qartë që romët njiheshin si nënshtetas, dhe kësisoj bëheshin të dukshëm për “radarin” e shtetit, vetëm atëherë kur autoritetit i interesonte që të bëheshin të “padukshëm”. Gjithaq, është e kuptueshme që, në optikën e qeverisjes së kohës, kurimi i imazhit publik në përmbushje të vizionit modernizues të mbretit ishte më i rëndësishëm se nevojat e romëve për të ndërvepruar me këtë mjedis. Në perspektivën e autoritetit qeverisës, romët nuk konsideroheshin subjekte, por ornamente të padëshiruara, që nuk duhej të qëndronin as në sfondin e tablosë urbane që servirej për publikun, sidomos për shtetasit e huaj. Kësisoj, në planet e qeverisë, romët përfshiheshin vetëm në protokollet higjienizuese, të klasifikuar si papastërti, që duheshin pastruar dhe degdisur sa më larg hapësirës publike dhe në asnjë politikë që do të kishte për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës. Mania e pushtetit për t’i mbajtur sa më larg romët manifestohet jo vetëm në dëbimet nga qytetet, por edhe në vendimet për të mos lejuar rikthimin e tyre nga emigracioni apo ardhjen e individëve të tjerë nga kjo pakicë në Shqipëri. Domethënë, fakti që në këtë regjim ky grup etnik penalizohet përmes përjashtimit, jo sepse konsiderohet rrezik për shoqërinë dhe rendin (natyrisht edhe në këtë rast përjashtimi nuk do të ishte i justifikueshëm), por sepse nuk inkuadrohet mirë në “pikturën” e porositur nga instancat pushtetare, flet shumë për pozitën sociale të romëve asokohe.

Në kushtet e një mohimi të strukturuar prej shtetit, në përmasat e përjashtimit sistematik dhe jo thjesht të braktisur prej tij, romët, edhe në këtë periudhë, vijonin të ruanin të ruanin të njëjtën strukturë ekonomike dhe ndarje pune. Referuar vëzhgimit të Stuart Mann-it, në dy kampet e romëve në rrethinat e Tiranës, burrat e kampit të Korçës merreshin me rritjen dhe tregtinë e kuajve dhe mushkave, në bërjen e shportave dhe të luleve të

¹³ AQSh i RSH, Fondi 271, Dosja: 67, 1934, fl. 1.

letrës. Ndërsa në kampin e Shkodrës merreshin me asgjësimin e qenve (punë e paguar nga bashkia) dhe, me raste, me tregti kuajsh (Mann 1933, 2). Në këtë periudhë, Shqipëria vizitohej nga shumë udhëtarë, studiues, shkrimtarë, gazetarë e individë me misione apo punë të caktuara, të cilët vëzhgimin e tyre e lëvruan në shkrime të llojeve të ndryshme. Por, sikurse diskutohet edhe në fillim të kapitullit, janë të paktë autorët që ndalen te romët në tekstet e tyre. Një prej tyre është Oakley-Hill (oficer britanik i ngarkuar me punë në Shqipëri me detyrën e organizimit të xhandarmërisë në vitin 1930), i cili, në tekstin mbi kujtimet e tij, ndalet edhe në përshkrimin e romëve. Ashtu si edhe Mann-i e Hasluck-u, ai shquan dy tipologji “ciganësh”. Të parët ishin endacakët që flisnin gjuhën rome dhe bënë shporta xunkthi, e nganjëherë mbanin edhe arinj, ndaj dhe emri me të cilin thirreshin ishte arixhi. Grupi i dytë përbëhej nga ciganë sedentarë që jetonin në qytete, flisnin vetëm shqip dhe shumica i quante jevgi. Gratë e tyre vishnin çitjane prej pambuku me pika blu ose të kuqe dhe me jelekë të vegjël që u rrinin pas trupit. Burrat luanin një muzikë pak a shumë orientale nëpër dasma dhe panaire. (D.R. Oakley-Hill 2002, 15-16).

Margaret Hasluck solli studimin më të thelluar të romëve në këtë periudhë. Ajo hamendësonte që popullata rome asokohe duhej të ishte rreth 20000 persona nga komuniteti i sedentarëve dhe jo më shumë se 2000 nomadë, gjë që, në këndvështrimin e saj, ishte një numër i konsiderueshëm, duke pasur parasysh që në total popullata e Shqipërisë ishte rreth 1 milion banorë. Si shënim, për statistikën zyrtare të kohës, në raport me matjen e popullatës, duhet evidentuar fakti se, që nga shpallja e pavarësisë e deri në instalimin e regjimit komunist, janë realizuar dy censuse, në vitet 1923 dhe 1930. Të dy censuset konsistonin vetëm në numërimin e popullsisë, gjë që shërbeu për krijimin e një lloj regjistri të gjendjes civile, me bazë moshën dhe gjininë, pa i përfshirë pakicat si zë specifik (INSTAT 2014). Referuar Joseph Roucek-ut, në numra pakicat nuk përbënin problem për shtetin shqiptar, sepse homogjeniteti etnik i shqiptarëve supozohet të ishte më solid, krahasuar me shtetet e tjera ballkanike, pasi 92% e popullatës kishin kombësinë shqiptare, 4.1% ishin grekë dhe 3.1% nga kombësi të tjera të papërcaktuara (Roucek 1939, 86). Duke i marrë si të mirëqena këto shifra, romët bëjnë pjesë në 3.1% e kategorisë pakica të tjera. Për pasojë, jo vetëm sepse ishin pak në numër (sepse, me të drejtë, Apadurai (2011) nënvizon që

numrat e vegjël në çdo rrethanë përbëjnë rrezik për shtetin-komb), por, mbi të gjitha, për faktin që romët nuk mbroheshin as nga ndonjë shtet dhe as nga ndonjë organizëm ndërkombëtar, ishte e lehtë të trajtoheshin prej shtetit.

Le të rikthehemi sërish tek Margaret Hasluck-u për sa kemi të bëjmë me përshkrimin më të plotë të strukturës sociale dhe ekonomike të romëve në atë periudhë, duke u ndalur në disa prej komponentëve më të rëndësishëm. Në artikullin e saj Hasluck-u skicon përmes përshkrimeve të hollësishme profilin e romëve sedentarë dhe romëve nomadë, duke shquar edhe dallimet mes tyre ashtu si edhe mes fiseve të ndryshme, gjithashtu na ofron edhe një panoramë të marrëdhënieve me shumicën shqiptare. Shumica e sedentarëve jetonin në shtëpi njëkatëshe me një strukturë të ngjashme me shumicën e shqiptarëve të varfër, të përbërë vetëm nga dy dhoma, një dhomë ndenjeje me oxhak dhe një fjetjeje. Në qytete, shtëpitë e tyre ishin të vendosura në një lagje të veçantë. Një pjesë e sedentarëve jetonin në kasolle të ndërtuara me çati kashte, pa dritare, pa mobilie dhe me një vatër zjarri në mes të shtëpisë. Për shkak të strukturës së dobët të shtëpive, frika e tyre më e madhe ishte era. Ndonjëherë edhe nomadët banonin përkohësisht, për disa muaj në qytete, në shtëpi me qira. Kur mbaronte afati ata/ato hiqnin dorë nga shtëpia dhe ktheheshin në jetën e çadrës. Kolonitë e sedentarëve, siç i quan studiuesja, vendoseshin kryesisht në tokat e bejlerëve, ku dhe ndërtonin kasolle pa paguar qira, me kushtin që duhet të punonin familjarisht pa pagesë në tokat e tyre. Në pak raste ndodhte që të jetonin përkohësisht, në të njëjtën hapësirë fizike, nomadët dhe sedentarët, por, megjithatë, Hasluck-u nënvizon që nuk kishin marrëdhënie të mirë mes tyre. Nomadët i shihnin si inferiorë sedentarët dhe kurrë nuk do të pranonin t'i jepnin vajzën e tyre. Çadrat e nomadëve ishin të llojit më të thjeshtë, një shtyllë e ngulur drejt në tokë në qendër dhe çadra hidhej rrotull si një mantel. Përshkrimin e ansamblit të të mirave materiale të romëve nomadë e gjej me mjaft interes, ndaj po e sjell të plotë sipas Hasluck-ut:

“Gjenden vetëm jorganë dhe dyshekë prej kashte në shtratin e krevateve, ashtu siç shërbejnë edhe gjetet dhe degët e pemëve për dyshekë. Një tenxhere dhe një tigan janë enët kryesore. Në këtë mënyrë një gomar mund të transportojë të gjithë të mirat e kësaj bote të një familjeje. Një djep nuk

gjendet kurrë; (...) bëhet një barrë e padobishme. Nëse fëmija e një gruaje është shumë e vogël, ajo e mban atë drejtë në një hobe të cilën e hedh mbi një sup dhe e lë lëkundur mjaft poshtë në shpinë për te këmbët e foshnjës të mbështetur në ijë. Kur fëmija është më i madh, ajo e mban në krah si një nënë angleze.”

Disa prej punëve të zakonshme ishin të njëjta si për ciganët nomadë ashtu edhe për sedentarët. Të dy grupet lypnin (kërkonin lëmshë), megjithëse me disa ndryshime interesante. Babai rom nomad, i pajisur me një shkop shumë të gjatë, orientonte gruan dhe fëmijët që të mblidhnin gjëra shtëpi më shtëpi, ndërsa babai sedentar nuk merrte kurrë pjesë në ekspeditat e lypjes. Bërja e shportave ishte një punë tjetër e ngjashme, me pak dallime në produktet finale dhe hapësirën e tregtimit. Nomadët ishin më të shkujdesur dhe kryesisht bënë vetëm shporta jo fort të rregullta për përdorim në shtëpi, ndërsa sedentarët prodhonin sende më të komplikuar, si koshat, që përdoreshin për transportin e mallrave me kafshë.

Mjekimi praktikohet nga të gjitha gratë rome dhe Hasluck-u e ilustron me ndodhi konkrete ushtrimin e kësaj aftësie, që përfshinte një gamë të gjerë ndërhyrjesh me përdorimin e bimëve, shushunjave dhe deri në forma të caktuara të magjisë. Nga përshkrimi duket që këto njohuri aplikoheshin te gratë dhe te burrat romë, ashtu si edhe te fshatarët.

Kishte edhe romë që merreshin me bujqësi, duke përdorur metodat dhe mjetet më primitive, ashtu si edhe shumica e shqiptarëve. Kryesisht punonin në procesin e korrjes gjatë muajve qershor-korrik si burrat edhe gratë. Një veçori e pikasur nga autorja ishte të punuarit në orët e nxehta të ditës, shoqëruar me të kënduarin. Për punën e kryer paguheshin në bazë të pagesës ditore që përfitonin edhe shqiptarët, ndërsa në pak raste shpërbleheshin që të mblidhnin nga pas të korrurat. Gjithsesi, ajo thekson që të gjithë punëtorët ditorë romë ishin shumë të varfër. Një punë tjetër që e kryenin të dy grupet ishte mbledhja dhe shitja e kërmijve. Duke u ndalur në zanatet specifike të romëve nomadë, me argumentin se emërtimet e fiseve burojnë nga profesioni me të cilin merren, Hasluck-u shquan disa prej tyre. Një prej grupeve nomade, shoshatarët, merreshin vetëm me bërjen e sitave. Arrixhinjtë me rritjen dhe trajnimin e arinjve për kërcime dhe për të bërë masazh, duke hipur në kurrizin e personit që kërkonte të

masazhohej. Emërtimin gabel e lidh me punën e nomadëve në tregtimin e kuajve. Parashikimi i fatit praktikohet nga të gjitha gratë nomade, megjithëse asnjë shqiptar, muhamedan apo katolik nuk preferonte që ta merrte këtë shërbim, me gjykimin që kjo praktikë ishte mëkat. Përsa i përket marrëdhënies së romëve me shqiptarët, Hasluck-u del në përfundimin se këto të fundit i përbuzin. Në këtë kontekst ajo sjell shumë gojëdhëna, shprehje të së përditshmes dhe raste konkrete që ilustrojnë qëndrimin e shqiptarëve kundrejt romëve. Ndër këto, po sjell vetëm dy raste domethënëse. Në xhami, megjithëse lejoheshin të hynin brenda, mund të qëndronin vetëm në pjesën e pasme, ndaj, dhe për pasojë, në Durrës kishin ndërtuar xhaminë e tyre. Ndërsa, në Gjirokastrë, romët ortodoksë ishin të detyruar të qëndronin në një pjesë të veçantë të kishës.

Përpos botimeve të autorëve të huaj janë qëmtuar edhe botimet e autorëve shqiptarë në kërkim të shkrimeve mbi romët. Kjo periudhë ka qenë e begatë edhe për lëvrimin e mendimit shqiptar në lëmenj të ndryshëm, të botuara në revista të profilit kulturor, ekonomik e politik. Megjithatë, pavarësisht një kërkimi të imët, nuk gjendet asnjë artikull i plotë apo sythe a kapituj libri me fokus pakicën rome. Puna intelektuale e studiuesve shqiptarë, madje edhe e shumë studiuesve të huaj që vizituan Shqipërinë, duke nisur prej viteve të fundit të Perandorisë Osmane e në vazhdim, kishin si lajtmotiv kryesor shqetësimin për krijimin e shtetit-komb dhe aftësisë së shqiptarëve për ta përmbushur këtë ideal. Rreth këtij toposi rrotullohej e gjithë energjia intelektuale e kohës dhe çdo çështje tjetër fitonte valencë, për sa komunikonte me këtë frekuencë shqetësimesh.

Edhe kur gjendet ndonjë shkrim, kjo pakicë zë pak rreshta, me konstatime sipërfaqësore, si në rastin e Konicës në “Shqipëria kopshti shkëmbor i Europës Juglindore”. Këtu, pas shpjegimit të qasjes së tij mbi konceptin e racës në tërësi, domethënies mbi “racën shqiptare” në veçanti dhe pohimit se racat e tjera të pranishme në Shqipëri nuk janë më shumë se 3-4%, ndalet shkurtimisht te romët, duke thënë që:

“Elementët e huaj më interesantë në Shqipëri janë ciganët. Si në çdo vend, edhe këtu ndahen në dy kategori: ciganët shëtitës dhe ciganët jo shëtitës (të ngulitur në një vend të caktuar). Të parët janë shitës dhe blerës kuajsh, thurin shporta e kanistra, kurse të dytët punojnë si kovaçë, bakërpunues, muzikantë dhe valltarë. Gratë shpeshherë shërbejnë për të kënaqur burrat

(femmes de plaisir). Ciganët e Shqipërisë janë njerëz të butë e të padëmshëm dhe ata të Tiranës (të cilët shpeshherë janë krejt biondë, për të njëjtën arsye që ju mund të shihni zezakë flokëverdhe në Jug të Shteteve të Bashkuara) kanë një farë prirjeje në veshje dhe në vallëzim” (Konica 1993, 410- 411).

III. Romët mes fashizmit dhe nazizmit në Shqipëri

Në prill të vitit 1939 Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste. Nga ky moment Shqipëria nis të zhytet thellë në totalitarizmat e njëpasnjëshëm që i lënë “stafetën” njëri-tjetrit, nga fashizmi në nazizëm e në fund në komunizëm, regjime që përzgjidhnin në bazë të kritereve ideologjike dhe taksonomisë që derivonte prej tyre, grupet, individët e gjërat për t’u transformuar tërësisht në fabrikat e tyre sociale, ose të destinuara për t’u asgjësuar. Romët, fatkeqësisht, në mënyrë të veçantë në platformën naziste të klasifikimit të racave e grupeve shoqërore, bënë pjesë në grupet e përzgjedhura për t’u eliminuar fizikisht. Domethënë, romët në Shqipëri e kudo në Europë e gjetën veten brenda një regjimi që e kishte imperativ ideologjik seleksionimin racial dhe gjenocidin si metodë e përmbushjes së imperativit. Sikurse dhe dihet, dogma themeluese e këtij rendi të ri, që ngrihej mbi darvinizmin social dhe hierarkinë racore, e ktheu në praktikë rutinore asgjësimin e çdo grupi të vlerësuar si racë inferiore, të klasifikuar përmes kritereve shkencore të aparatit shkencor nazist. Sikurse edhe dihet, raca ariane u shpall raca superiore dhe gjermanët në majën e hierarkisë së kësaj race, ndërsa kushdo që nuk bënte pjesë në këtë bashkësi imagjinare, duhej t’i nënshtrohej “kirurgjisë” eugenike. Megjithëse asokohe ishte vërtetuar nga antropologë dhe gjuhëtarë se romët bënë pjesë në familjen indo-europiane, shkencëtarët nazistë bënë çmos që t’i skualifikonin prej kësaj përkatësie gjenetike, duke arsyetuar se përse nuk ishin dhe përse nuk e meritonin të ishin pjesë e racës superiore. Donald Kenrick dhe Gratta Puxon (1972) në librin e tyre “Fati i Romëve të Europës”, ku trajtohet thellësisht holokausti rom, duke e cilësuar, jo rastësisht, me sarkazëm një nga kapitujt e librit si *jo-arianët arianë*, deshifrojnë në mënyrë të detajuar e të faktuar debatin shkencor mbi klasifikimin racor të romëve. Studiuesit e të gjithë spektrit që përfshinte armata shkencore naziste, si antropologë,

biologë e mjekë argumentuan nga këndvështrimet e disiplinave përkatëse se përse romët, së bashku me hebrenjtë, përbëjnë dy popujt e huaj për Europën. I cituar nga dy autorët, studiuesi nazist Hans Gunther, në librin *Antropologjia e Europës*, të cilësuar si bibla e antropologjisë naziste, shtron argumentin se romët, pavarësisht se kanë marrë disa elementë nga origjina e tyre nordike, vijnë nga kasta më e ulët e atij rajoni (Kenrick dhe Puxon 2009, 17). Gjithashtu, përgjatë emigrimit në drejtim të Europës, gjaku i tyre ishte përzier me raca të tjera, duke prodhuar një racë mikse, orientale dhe aziatiko-perëndimore, gjë që i bënte të huaj për Europën. E thënë në terma të përmbledhur, të gjitha përfundimet e shkencëtarëve nazistë konvergojnë në pohime, si: ata janë “gjak i huaj”, “element i huaj për kombin”, “kriminelë”, “të pamoralshëm”, “dembelë”, “të paedukueshëm”, “asocialë”, “të paintegrueshëm”. Ata, veç të tjerash, shiheshin si kërcënim edhe për shkak të normës së lartë të lindshmërisë. Shkencëtarët nazistë, pasi i klasifikuan romët si joarianë, u kujdesën gjithashtu që të propozonin edhe një gamë të gjerë metodash për shndërrimin e tyre, si ndarjen biologjike, asimilimin, deportimin dhe sterilizimin (Kenrick dhe Puxon 2009, 59-75). Qeveria naziste, kur mori pushtetin në vitin 1933, e gjeti të kultivuar frymën anti-rome të materializuar në ligje që legjitimonin persekutimin e këtij grupi etnik. Legjislacioni u pasurua me ligje të reja, ndërsa ato ekzistueset u bënë edhe më të ashpra, duke e zgjeruar gamën e operacioneve ndaj romëve me dëbimin me forcë nga zona e tyre e banimit, moslejimin e udhëtimit dhe tregtisë, mbylljen në kampe përqendrimi, ndalimin e martesave me gjermanët, me argumentin se kontaminohet gjaku arian. Megjithatë, të pakënaqur me masat e marra, në vitin 1938, u miratua dekreti i parë i adresuar specifikisht për romët që e etiketonte si një *racë* që duhej të ndahej përfundimisht nga raca ariane, ndërsa në vitin 1939 nisi të aplikohet një strategji e posaçme për persekutimin sistematik të romëve (Kenrick dhe Puxon 2009, 21-30).

Në këtë kohë, e njëjta paketë politikash e ligjesh e hartuar për hebrenjtë, ashtu si edhe e njëjta teknologji e shfarosjes, u aplikua edhe për romët. Vendimi i parë që u ndërmor në këtë aspekt ishte deportimi në getot e Polonisë dhe në kampet e përqendrimit, disa prej të cilave të ndërthuara posaçërisht për romët (po aty, 31). Në dhjetor të vitit 1942, Himler-i lëshoi një dekret për dërgimin e romëve të Gjermanisë në Aushvic

dhe për shfarosjen e tyre në gjithë Europën (po aty, 41). Prej këtij momenti romët, ashtu si edhe hebrenjtë, reduktohen në statistika, në produktin final të makinerisë burokratike çnjerëzore të shfarosjes, të udhëhequr nga racionaliteti instrumental, në qoftë se do i qaseshim kësaj çështjeje duke perifrastuar analizën e Bauman-it (2015, 40-41). Tmerri i shkaktuar nga holokausti rom zgjati deri në kapitullimin e Gjermanisë naziste dhe hamendësohet se shkaktoi nga dyqind gjer në një milion viktima nga kjo etni në të gjithë Europën.¹⁴ Edhe në shumë vende të Europës Lindore që ishin të pushtuar nga nazistët u ndoqën praktika të ngjashme të dëbimit, persekutimit e gjenocidit.

Edhe në Shqipëri diskursi racial u intensifikua gjatë periudhës së pushtimit fashist, si kombinim i ligjëritimit mbi identitetin kombëtar dhe racën, ku, veç interesave të tjera, shpalohej edhe synimi për të kultivuar vetëdijen raciale (Lelaj 2018, 13-40). Megjithatë, edhe në organet e shtypit të shkruar, që shërbenin drejtpërdrejt si “megafoni propagandistik” i fashizmit në Shqipëri, si gazeta *Tomorri*, ashtu edhe në revista shkencore të kohës, nga kërkimi që kam mundur të bëj nuk kam gjetur ndonjë shkrim apo artikull që fokusohet te romët. Gjithashtu, në praktikë, në Shqipërinë e pushtuar nga Italia fashiste, deri në vitin 1943, studiuesit pohojnë që në përgjithësi romët kanë vijuar jetën e tyre në paqe. Kjo mund të shpjegohet me faktin që edhe në Itali ndaj romëve nuk u aplikua ndonjë politikë qendrore, me synim persekutimin dhe shfarosjen e tyre, ndryshe nga se u veprua me hebrenjtë, ndaj të cilëve u zbatuan të njëjtat ligje si edhe në Gjermani (Kenrick dhe Puxon 2009, 106). Me pak fjalë, romët në Shqipëri, gjatë pushtimit fashist, duke përfshirë këtu edhe territorin e Kosovës, që në vitin 1941 u bë pjesë e Shqipërisë së Madhe, nuk u persekutuan dhe, mbi të gjitha, arritën t’i shpëtonin gjenocidit (Crowe 2007, 221). Kolsti arsyeton se një prej faktorëve kryesorë që ka ndikuar në mbijetesën e romëve ishte struktura demografike e shoqërisë, duke nënvizuar faktin që romët nuk ishin i vetmi grup etnik në rajonet shqiptare (këtu e ka fjalën për të gjitha trojet që ishin bërë pjesë Shqipërisë së Madhe nën pushtimin fashist).

¹⁴ Në mungesë të dokumentimit, studiuesit përlllogarisin statistika të ndryshme mbi numrin e romëve të vrarë. Shih: Hancock 1987; Kenrick dhe Puxon 1972; Stewart 1997; Liegeois 1994; Fonseca 1995.

“Mëhallat turke dhe vendbanimet vllehe të shpërndara kudo ia bënin të vështirë pushtuesit që të dallonte elementët jo-sllavë apo jo-grekë në një popullatë që ndante prej kohësh të njëjtat vështirësi ekonomike dhe të njëjtin model patriarkal jetese” (Crowe dhe Kolsti 1991, 54-55). Gjithashtu ai shton se as italianët as aleatët e tyre bullgarë dhe as nacionalistët shqiptarë, që u bënë palë me fashistët dhe, më vonë, me nazistët në favor të Shqipërisë së Madhe, nuk ishin të interesuar për asgjësimin e romëve (që përbënin një pakicë të pakonsiderueshme në numra) përballë çështjeve të tjera më të rëndësishme, si rreziku i humbjes së territoreve të pushtuara.

Nga shqyrtimi i dokumenteve arkivore rezulton se janë marrë disa masa nga qeveria kolaboracioniste, e drejtuar nga Shyqyri Verlaci dhe më pas nga Mustafa Kruja, ashtu si edhe nga autoritetet lokale. Megjithatë, asnjë nga këto vendime nuk dëshmon ekzistencën e ndonjë strategjie apo qoftë edhe politike qendrore, që kishte për synim internimin apo asgjësimin e romëve, ndërkohë që nazistët i kishin klasifikuar si një prej racave që duheshin asgjësuar.

Në një qarkore të vitit 1943, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kërkohet që të merren masat për mosgrumbullimin në kryeqytet të të varfërve, të papunëve dhe arixhinjëve.¹⁵ Në një korrespondencë të vitit 1940, midis nënprefekurës së Fierit dhe komandës së një ndërmarrjeje private, kërkohet që të merren masat për largimin e romëve nga qyteti.¹⁶ Në një korrespondencë tjetër të vitit 1940, midis drejtorisë qendrore të partisë fashiste dhe karabinierisë së Elbasanit, kërkohet informacion në lidhje me numrin e “Arixhinjve dhe Jevgiëve dhe të merren masat për ti ndihmuar”.¹⁷ Në një qarkore të kryesisë së Këshillit të Ministrave, në vitin 1942, i kërkohet Ministrisë së Brendshme, që të krijonte një inspektoriat të përgjithshëm për të ndjekur “keqsjelljen e arixhinjve në popull”.¹⁸ Në një qarkore të Ministrisë së Brendshme, të vitit 1943, kërkohet largimi i “Arixhinjve nga kryeqyteti si përhapës epidemishë dhe prishës të shëndetit

¹⁵ AQSh i RSH, Fondi: 267, Dosja 21, Viti: 1943, fl. 3.

¹⁶ AQSh i RSH, Fondi: 223/1, Dosja: 35, Viti: 1940, fl. 2.

¹⁷ AQSh i RSH, Fondi: 164, Dosja: 153, Viti: 1940, fl. 6.

¹⁸ AQSh i RSH, Fondi: 152, Dosja: 111, Viti: 1942, fl. 6.

publik”.¹⁹ Po atë vit, në një qarkore të Ministrisë së Brendshme drejtuar kuesturave, u kërkohej këtyre të fundit të raportonin për masat e marra për dëbimin e “Arixhinjve”.²⁰ Romët, megjithëse vijonin të trajtoheshin si qytetarë të dorës së dytë dhe të ishin të përjashtuar, aq sa nga dokumentet vërehet që dëbimi nga qytetet përbën masën kryesore dhe më ekstreme ndaj romëve, fatmirësisht nuk mund të krahasohen me atë çka po vuante kushdo që i përkiste kësaj etnie kudo tjetër në Europë.

Me kapitullimin e Italisë fashiste dhe pushtimin e Shqipërisë nga Gjermania naziste në vitin 1943, politikat e ndërmarra kundrejt romëve u bënë më agresive. Mendohet që gjatë kësaj periudhe disa romë shqiptarë u dërguan në kampet e përqendrimit në Jugosllavi dhe kampe të tjera në Europë (Kenrick, Puxon 1995, 81). Tregohet gjithashtu një histori për disa romë që i dërguan në një kamp në jug të Shqipërisë dhe që nuk u kthyen më, por edhe kjo është e pabazuar në fakte. Megjithatë, të gjithë studiuesit e rastit të romëve të Shqipërisë, që u diskutuan këtu, pohojnë se Shqipëria ka qenë nga rastet me më pak humbje jetësh nga pakica rome. Në këtë prizëm, evidentohen disa faktorë që ndikuan. Së pari, sepse nazistët qëndruan në Shqipëri një vit dhe në kushtet e vulnerabilitetit ushtarak në të cilin gjendeshin, nuk mundën të fokusoheshin edhe në trajtimin e grupeve etnike (Fraser 1995, 267). Së dyti, sepse klasifikimi i grupeve etnike në territorin e Shqipërisë së Madhe nuk ishte një proces i lehtë, për shkak të kompozimit heterogjen të një shoqërie të përbërë nga disa etni (Crowe dhe Kolsti 1991, 55). Së treti, për arsye se një pjesë e romëve mbështetën autoritetet lokale fashiste e më vonë naziste, për të kontribuar kundër një armiku edhe më të madh si serbët²¹. Disa romë u bashkuan edhe me forcat komuniste partizane (Crowe 2007, 221).

¹⁹ AQSh i RSH, Fondi: 236, Dosja: 207, Viti: 1943, shtesa 1.

²⁰ AQSh i RSH, Fondi: 153, Dosja: 384, Viti: 1943, fl. 25.

²¹ Ky qëndrim ndaj Serbisë është më i pranishëm te romët myslimanë që kanë jetuar në territorin e Kosovës, sesa Shqipërisë së sotme, të cilët kishin vuajtur ashtu si edhe shqiptarët terrorin serb.

IV. Përfundime

Si konkluzion, në lidhje me romët e Shqipërisë mund të thuhet që, si pasojë e kombinimit të disa rrethanave historike, i shpëtuan gjenocidit dhe ia dolën të mbijetonin. Por, çka është lehtësisht e dallueshme, në të tri etapat e modernitetit, që u diskutuan në këtë radiografi historike, historia e romëve është ajo e një grupi etnik të padëshiruar, të përjashtuar dhe të marginalizuar. Kundrejt tyre, megjithëse me dallime midis vendeve të ndryshme ku kanë jetuar, në thelb, autoritetet kanë ushtruar metodën politike të persekutimit sistematik për të mbërritur deri te logjika e “zgjdhjes përfundimtare” që prodhoi gjenocidin rom, bazuar në ligje, politika e protokolle të posaçme. Shqipëria, sipas studiuesve, për të gjitha arsyet që u diskutuan në këtë artikull, krahasimisht me vendet e tjera (Weiss-Wendt 2013)²², mund të klasifikohet si një nga hapësirat më të paqta për romët. Megjithatë, po aq e qartë është që edhe autoritetet politike që kanë sunduar në Shqipëri kanë bërë maksimumin e mundshëm për të skajuar romët, në përputhje me peshën që mbartnin në peshoren e tyre politike dhe me kohën që patën në dispozicion për të ekzekutuar pushtetin. Thënë ndryshe, në qoftë se do ta zbërthenim në elementët kyç matricën politike të aplikuar ndaj romëve në këtë periudhë të modernitetit shqiptar dominon dëbimi nga zonat e banuara dhe përjashtimi sistematik përmes izolimit apo segregimit të tyre në territore të veçuara për romët nomadë dhe në lagje të posaçme për bashkësinë që cilësohet nga studiuesit si romët sedentarë. Trajektorja e administrimit politik të romëve në këtë periudhë të modernitetit shqiptar kalon nga mohimi i strukturuar i akomoduar në politikat estetizuese të Zogut, në rrezikun e implementimit të planit gjenocidal nga Gjermania naziste. Megjithatë, rrugëtimi i tyre në modernitetin shqiptar sapo kishte nisur, pasi romët detyrohen t’i nënshtrohen për 45 vite një tjetër projekti modernizues të një tjetër regjimi totalitar - komunizmit, i cili, ashtu siç kishte për synim final të krijonte njeriun e ri shqiptar, kërkonte të kërkonte edhe njeriun e ri rom. E

²² Për të krahasuar, por dhe të kuptuar më shumë se si është zbatuar politika eugenike naziste kundrejt romëve në vende të tjera të Europës përtej Gjermanisë, shih “The nazi genocide of the Roma”, 2013.

përbashkëta e të gjitha projekteve ideologjike totalitare të modernitetit, në territoret ku janë ndeshur me romët, është shënjestrimi i këtyre të fundit si entiteti primitiv që ose duhej rimodeluar i tëri ose duhej asgjësuar. Natyrisht, gjithçka shfaqet si pengesë për aparatet monokratike të moderniteteve, ose transformohet si botë e përveçme për t'u absorbuar brenda botëkuptimit njëdimensional dogmatik, ose nxirret jashtë dhunshëm, deri në asgjësim. E thënë me fjalët e Giorgio Agamben: “totalitarizmi modern mund të përkufizohet si vendosja përmes gjendjes së jashtëzakonshme e një lufte civile legale, luftë e cila lejon jo vetëm zhdukjen e kundërshtarëve politikë, por edhe atë të kategorive të tëra qytetarësh, të cilët për ndonjë arsye të caktuar rezultojnë si të paintegrueshëm në sistemin politik” (Agamben 2016, 10). Romët, edhe në rastin e Shqipërisë, ku për shkak të sfondit historik të vendit projektet modernizuese u ndeshën me një kontekst të vështirë, veçohen për t'u bërë të dallueshëm si pengesa permanente, që sfidojnë si aparatën shkencor ideologjik ashtu edhe teknologjinë e pushtetit. Kudo ishin një territor njerëzor i eksperimentimit të të gjitha formave kolonializuese të modernitetit, lakmues i ideologjive të imponuara në këtë epokë dhe hallkë fundore e shkarkimit të praktikave racionalizuese të racionalitetit formal e instrumental (sipas kuptimit Weberian mbi racionalitetin). Romët, për aparatën drejtues dhe atë zbatues të totalitarizmave, ishin “mishi i huaj” në “organizmat e shëndoshë” që po zhvilloheshin në rendet e reja apo një prej barërave të këqij që duheshin shkukur në qoftë se do të përdornim metaforën e Bauman-it (2015, 141). Bauman, po ashtu, argumenton se, megjithëse nazizmi ishte absolutisht një produkt modern, dogma naziste i portretizoi çifutët²³ si racën që mishëronte modernitetin dhe këtë të fundit në kundërshti me idealin shoqëror *volksisch* të së ardhmes. Me këtë optikë, “eliminimi i hebrenjve u trajtua veç të tjerash si sinonimi i mohimit të rendit modern” (Po aty, 99-100). Nisur nga kjo premisë interpretative,

²³ Mendoj se në gjuhën shqipe, në qoftë se bëjmë një vlerësim semantik, termi çifut mbart konotacion negativ, duke nënkuptuar një njeri koprrac, egoist dhe të pashpirt. Kjo është arsyeja që në tekst i referohem me termin hebre, përjashto këtë moment që përdoret termi çifut për të qenë korrekt me përkthimin në origjinal.

mendoj se, nëse hebrenjtë shiheshin si arketipi i modernitetit, romët përfaqësonin “artefaktin” e një bote të së shkuarës që, po ashtu, duhej “pastruar” nga të gjitha regjimet e modernitetit, megjithëse me protokolle e modalitete të ndryshme.

Bibliografi

- Appadurai Arjun. 2011. *Frikë nga numrat e vegjël: një ese për gjeografinë e zemërimit*.
- Përkthyer nga Virgjl Muci. Tiranë: ISHM.
- Agamben Giorgio. 2016. *Gjendje e jashtëzakonshme*. Tiranë: Zenit.
- Barany Zoltan. 2002. *The East European Gypsies, Regime Change, Marginality, and Ethnopolitics*. New York: Cambridge University Press.
- Bauman. Zygmunt. 2015. *Moderniteti dhe Holokausti*. Përkthyer nga Enis Sulstarova. Tiranë: Pika pa Sipërfaqe.
- Castelan Georges. 1991. *Histori e Ballkanit*. Përkthyer nga Arben Puto, Luan Omari. Tiranë: Çabej
- Crowe David dhe John Kolsti, përg. 1991. *The Gypsies of Eastern Europe*. New York. M.E. Sharp inc.
- Crowe David. 2007. *A History of the Gypsies of Eastern Europe and Russia*. New York: Palgrave Macmillan (botimi II).
- D.R. Oakley-Hill. 2002. *An Englishman in Albania: Memories of a British Officer 1929-1955*, London: The Center for Albanian Studies.
- Fonseca Isabel. 1995. *Bury me Standing: The Gypsies and their journey*. USA: Vintage books.
- Fraser Angus. 1995. *The Gypsies*. Oxford: Blackwell Publishing.
- Gjorgjeviç Vladan. 2015. *Shqiptarët e Fuqitë e Mëdha*. Përkthyer nga Mustafa Kruja. Tiranë: Klubi i Poezisë.
- Hancock Ian. 1987. *Pariah Syndrome: An Account of Gypsy Slavery and Persecution*. Ann Arbor: MI: Karoma pub.
- Hasluck Margaret. 1938. “The Gypsies of Albania”. *Journal of the Gypsy Lore Society*. Vol XVII. Nr. 2. 50-125.

- Kenrick Donald, Puxon Grattan. 1973. *The destiny of Europe Gypsies*. New York: Basic Books, inc.
- Kenrick Donald dhe Grattan Puxon. 2009. *Gypsies Under the Swastika*. University of Hertfordshire Press.
- Konica Faik. 1993. *Vëpra*. Tiranë: Shtëpia botuese "Naim Frashëri".
- Liegeois, Pierre-Jean. 1994. *Roma, Gypsies, Travellers*. Council of Europe.
- Mann. E. Stuart. 1933. "Albanian Romani, The Gypsy Tribes". *Journal of the Gypsy Lore Society*. Vol. XII. Nr.1. 1-32.
- Roucek, Joseph S. 1939. *The Politics of the Balkans*. New York: McGraw-Hill. (Kapitulli V, "Albania," 84-98).
- Stewart, Michael. 1997. *The time of the gypsies*. Colorado: SHBA, Westview Press.
- Sugar. F. Peter. 2007. *Europa Juglindore nën sundimin Osman 1354 – 1804*. Përkthyer nga Natasha Bombaj dhe Kujtim Ymeri. Tiranë: Dituria.
- Swire Joseph. 1937. *King Zog's Albania*. London: Robert Hale and Company.
- Tomes. J. H. 2003. *King Zog of Albania: Europe's Self-Made Muslim King*. New York University Press.

